



**KONTROLLI I LARTË I SHETITIT
KRYETARI**

Nr.246/7 Prot.

Tiranë, më 14.06.2016

V E N D I M N R . 6 0

**PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DEGËN
RAJONALE TË INSPEKTORIATIT SHETETËROR TË MJEDISIT DURRËS
“MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË
EKONOMIKO–FINANCIARE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në mbështetje të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko–financiare” të ushtruar në Degën Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Durrës, për periudhën 01.01.2014-31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A .MASA ORGANIZATIVE

1. Gjatë auditimit të raporteve të Sektorit të Inspektimit Mjedisit, rezulton se nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuar sipas ndikimeve që kanë në mjedis për subjektet të cilat operojnë në Qarkun e Durrësit dhe që janë të pajisur me leje mjedisi.

-Për vitin 2014-2015, janë hartuar plane por nuk janë caktuar subjektet, të cilat do të inspektohen. Këto mosveprime janë në kundërshtim me Urdhrat e Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.04.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë" dhe urdhrin nr. 4 datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut",

- Sektori i Inspektimit të Mjedisit pranë DR ISHMP Durrës, nuk ka hartuar plane mujore të inspektimit për subjektet që nuk janë pajisur me leje mjedisi, nuk ka hartuar plane inspektimi për të kontrolluar respektimin e kushteve nga subjektet që disponojnë leje mjedisi; nuk ka hartuar plane mujore inspektimi në lidhje me raportet e vetmonitorimit që subjektet e pajisur me Leje Mjedisit e kanë detyrim ligjor për t'i dorëzuar pranë DRM Qarku Durrës, sipas afateve të përcaktuara në kushtet e Lejes së Mjedisit; nuk janë hartuar plane inspektimi për subjektet e pajisur me Leje Mjedisit të Tipit C dhe autorizim mjedisor, për të kontrolluar shlyerjen e tarifave vjetore, si detyrim ligjor të përcaktuar në kushtet e lejes; si dhe nuk janë ndërmarrë sanksione administrative ndaj subjekteve, që nuk kanë bërë pagesën e tarifave vjetore. Këto mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e Mjedisit", VKM nr. 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të Lejeve të Mjedisit"; VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të Mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në lëshimin e këtyre nga QKL-ja .

Për këtë rekomandoj:

Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve (DR ISHMP) Durrës në bashkëpunim me institucione të tjera (Drejtorinë e Tatimeve Durrës, Drejtorinë Rajonale të Mjedisit, Qarku Durrës) të krijojë një bazë të dhënash për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Qarkun e Durrësit, mbi disponimin e Lejeve të Mjedisit të Tipit (A, B ose C) dhe në bazë të këtyre të dhënave, Sektori i Mjedisit të bëjë identifikimin e subjekteve me risk të lartë me ndikim në mjedis dhe të hartojë planin e inspektimeve mbi bazë risku, me synim rritjen e performancë në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Menjëherë

2-DRM Durrës, me shkresë nr. 741, datë 09.06.2014, drejtuar DR ISHMPU Durrës, ka dërguar listën e subjekteve me leje dhe subjekteve pa leje në Qarkun e Durrësit. Sipas kësaj shkrese, gjendja deri më 06.06.2014 për Qarkun e Durrësit paraqitet:

Subjekte gjithsej 1118, nga këto:

- Me leje mjedisi 788 subjekte

- Pa leje mjedisi 330 subjekte

Ndonëse nga DRM Qarku Durrës janë dërguar listat e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë qark dhe mosdisponimi nga ana e tyre i Lejeve të Mjedisit, nga DR ISHMP nuk është bërë ndonjë plan inspektimi për të urdhëruar subjektet të pajisen me leje mjedisi, sipas procedurave të miratuara nga kuadri ligjor, apo të procedohej me vendosjen e sanksioneve administrative për ushtrimin e aktivitetit pa leje

mjedisi. Ky mosveprim është në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e Mjedisi .

Për këtë rekomandoj:

-Nga ana e sektorëve të inspektimit të DR ISHMP Durrës, të merren masa që për të gjitha subjektet, që rezultojnë me mangësi në dokumentacion dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre pa leje mjedisi, të veprohet konform përcaktimeve ligjore dhe për rastet e moszbatimit të detyrimeve të zbatohen dënimet administrative që parashikon ligji nr. 10433, datë 16.06.2011“ Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdimisht

3-Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga Sektori i Inspektimit të Policisë Pyjore dhe Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave, referuar programit mujor të hartuar, konstatohet se nga Kryeinspektori DR ISHMPU Durrës, për vitin 2014 nuk janë lëshuar autorizime inspektimi dhe në rastet kur është inspektuar me autorizime, ato nuk janë bërë sipas objektit dhe qëllimit të inspektimit. Autorizimet gjithashtu, nuk janë plotësuar sipas elementëve të përcaktuara në përmbajtjen e autorizimit, veprime të cilat nuk përputhen me kërkesat e nenit 28 dhe 29 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë .

Për këtë rekomandoj:

-Kryeinspektori i DR ISHMP Durrës, mbështetur në rëndësinë që përfaqëson dokumentacioni i ndërmarrjes së inspektimit, të marrë masa që autorizimet që lëshohen për këtë qëllim të jenë në formatin e në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit. Gjithashtu autorizimet të lëshohen në përputhje dhe referuar programeve mujore të inspektimit të miratuara.

Menjëherë

4-Nga auditimi i rezultatit të inspektimeve të kryera nga Sektori i Inspektimit të Policisë Pyjore, Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave janë konstatuar një sërë problemesh e mangësish lidhur me dokumentimin, plotësimin e dokumentacionit të inspektimit dhe procedimin për kundërvajtjet në pyje, mjedis e ujëra. Në mbajtjen e procesverbaleve të inspektimit, procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjeve administrative si dhe vendimeve për dënim administrativ, shpesh herë mungon nënshkrimi i personit përgjegjës të kontrolluar dhe data e marrjes në dorëzim të kopjes së vendimit për dënim administrativ. Në rastin kur është kundërshtuar nënshkrimi i procesverbaleve dhe vendimit për dënim administrativ, nga ana e inspektorëve nuk është evidentuar ky fakt, veprime këto që nuk përputhen me kërkesat e pikës 2, neni 14 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Për këtë rekomandoj:

-Inspektorët e Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore dhe të Sektorit të Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave të marrin masa dhe të bëjnë plotësimet e nevojshme në dokumentacionin e mbajtur për kundërvajtjet administrative të rezultuara nga inspektimi, sipas kërkesave të ligjit.

Menjëherë

5-Nga auditimi i raporteve të shërbimit, të sjella nga grupet e punës të Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore, rezulton se në këto raporte nuk evidentohen problemet, dhe janë raporte jo profesionalë. Në lidhje me raportimet ditore, që plotësohen nga ana e inspektorëve të Policisë Pyjore, pasi kanë kryer inspektimet, vihen re pasaktësi dhe mangësi në plotësimin e këtyre raporteve, vonesë në raportimet e autorizimeve të lëshuara si dhe në dorëzimin e vendimeve që merren për dënim administrativ, duke mos paraqitur në evidencat mujore që dërgohen pranë Drejtorisë së Inspektoratit të Policisë Pyjore Tiranë, gjendjen reale të shkeljeve dhe mangësive të konstatuara në këto subjekte .

Për këtë rekomandoj:

-Inspektorët e Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore, të marrin masa për të plotësuar në mënyrë korrekte formularët e raportimeve ditore, sipas përcaktimeve dhe kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.

Menjëherë

6-DR ISHMP Durrës nuk ka kërkuar informacion nga ISHMP Qendër, në lidhje me ankimimin administrativ pranë Komisionit të Ankimimit në ISHMP të subjekteve, ndaj të cilëve është marrë vendim për dënim administrativ, në kundërshtim me nenin 7/1 “Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake” të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit, dhe ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi Procedurës Administrative .

Për këtë rekomandoj:

-Kryeinspektori i DR ISHMP Durrës në bashkëpunim me juristin e Institucionit dhe strukturat përkatëse në ISHMP, të marrë masa për përcaktimin dhe ndjekjen e mënyrave efikase të shkëmbimit të informacionit me ISHMP dhe rritjen e bashkëpunimit kryesisht me Komisionin e Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë ISHMP, mbi subjektet që kanë ankimuar brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për gjobën, me synim respektimin e afateve ligjore për ndjekjen në rrugë gjyqësore të proceseve administrative për nxjerrjen e urdhrit ekzekutiv të gjobave .

Menjëherë

7-Për vitin 2014-2015 nga inspektorët e tre sektorëve të inspektimit të DR ISHMP Durrës, janë marrë gjithsej 132 Vendime për Dënim Administrativ në vlerën 33,638,000 lekë.

- Nga 132 gjobat e vendosura, 95 gjoba janë të vendosura nga Sektori i Policisë Pyjore, 30 nga Sektori i Mjedisit dhe 7 gjoba nga Sektori i Ujërave. Nga 132 subjekte ndaj të cilave janë vendosur sanksione administrative (gjobë) për vitin 2014 dhe 2015, vetëm 18 prej këtyre kanë bërë ankim në rrugë administrative pranë Komisionit të Ankimimit të ISHMPU-së. Komisioni i Ankimimit të ISHMPU pas shqyrtimit ka lënë në fuqi 16 vendime administrative dhe ka pranuar ankimimin për 2 vendime administrative.

Për 114 gjobat e vendosura, të cilat nuk janë ankimuar në Komisionit të Ankimimit të ISHMPU-së, është bërë padi pranë Gjykatës Administrative të Rrethit Gjyqësor Durrës dhe pritet nxjerrja e urdhrit ekzekutiv.

Sa më sipër cituar, kërkesat për shndërrimin në Titull Ekzekutiv pranë Gjykatës Administrative të rrethit Gjiqësor Durrës janë bërë jashtë afateve kohore. Gjithashtu kanë kaluar afatet kohore për shlyerje vullnetarisht të gjobave, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 44 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenit nr. 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Si pasojë e këtyre mosveprimeve është shkaktuar *e ardhur e munguar ne buxhetin e shtetit* në vlerën prej 32,538,000 lekë. U konstatua se gjobat e vendosura nga DR ISHMP Durrës për periudhën e audituar, nuk janë kontabilizuar, nuk janë ndjekur dhe nuk janë arkëtuar .

Për këtë rekomandoj:

DR ISHMP Durrës në bashkëpunim me ISHMP të marrë masat të kontabilizojë dhe të ndjekin të gjitha hapat ligjore për respektimin e afateve, që nga vendosja e sanksioneve administrative (gjoba) deri në ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv të nxjerrë nga Gjykata Administrative e rrethit Gjiqësor Durrës.

- DR ISHMP Durrës të marrë masat e nevojshme që pas përfundimit të afatit për shlyerjen vullnetarisht të masës së gjobës si dhe pas komunikimit zyrtar me Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave në ISHMP në lidhje me ankimin administrativ që mund të bëjnë subjektet apo personat ndaj të cilëve është vendosur sanksion administrativ, të bëjë kërkesë në gjykatë për lëshimin e titullit ekzekutiv të vendimit për dënim administrativ duke respektuar afatet e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

DR ISHMP Durrës në bashkëpunim me ISHMP për gjobat e vendosura në vlerën **32,538,000** lekë, pas zbatimit të procedurave ligjore të marrën masat për arkëtimin e tyre.

Menjëherë

8-Për 52 ankesa të protokolluara pranë DR ISHMP Durrës, nuk janë ndjekur procedurat ligjore, nuk janë lëshuar autorizime për inspektimet e këtyre ankesave, si dhe nuk është kthyer përgjigje zyrtare me shkrim ndaj subjekteve apo personave të cilët kanë bërë ankesën, duke vepruar në kundërshtim me nenin 7/1 “Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake” të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit, ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi Procedurës Administrative .

Për këtë rekomandoj:

- Nga Kryeinspektori i DR ISHMP Durrës të ndiqen të gjitha procedurat ligjore në lidhje me shqyrtimin dhe inspektimin e ankesave, për nxjerrjen dhe përcaktimin e përgjegjësive të shkelësve përkatës të ligjit në mënyrë që të parandalohen apo dhe të minimizohen efektet negative të asaj veprimtarie në mjedis.

Vazhdimisht

9-Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të inspektimeve të kryera rezultoi se nuk është studiuar mirë aktiviteti i subjektit, një pjesë e subjekteve të inspektuara e zhvillonin aktivitetin e tyre pa leje mjedisi. Formularët e inspektimit nuk ishin të plotësuar në të gjitha rubrikat, duke ju lënë afate në kohë të ndryshme për tu pajisur me leje mjedisore.

Gjithashtu në krye të procesverbalit nuk janë vendosur adresa e subjektit, nuk evidentohen subjektet me numër NIPT-i dhe nuk saktësohet qartë detyra që i lihet subjektit. Inspektorët nuk kanë bërë riinspektime për të kontrolluar nëse subjekti i ka realizuar detyrat e lëna nga inspektimi i mëparshëm si dhe evidentohen mangësi në njohjen nga ana e inspektorëve të bazës ligjore të inspektimit dhe të pajisjes me leje .

Për këtë rekomandojmë:

Inspektorët e DR ISHMP Durrës, me qëllim realizimin e inspektimeve në mbrojtjen e mjedisit dhe pyjeve, të marrin masat e duhura për përmbushjen e dokumentacionit konform respektimit të kërkesave ligjore, vlerësimin e këtyre kërkesave nga subjekti i inspektimit, dokumentimin e praktikave më të mira, këshillimin e subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore, urdhërimin e korigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore, dhënien e dënimeve dhe marrjes së masave të tjera administrative, si dhe kontrollin në vazhdimësi të zbatimit të detyrave të lëna nga inspektimet e mëparshme.

Menjëherë

10-Nga auditimi në lidhje me inspektimin e subjekteve dhe institucioneve që administrojnë dhe menaxhojnë mbetje spitalore, për periudhën 2014 - 2015 u konstatua se të gjitha qendrat shëndetësore të Qarkut Durrës janë të pa pajisura me Leje Mjedisore. Megjithëse janë kryer inspektime në këto qendra shëndetësore dhe janë konstatuar probleme të ndryshme, nga grupet e inspektimit nuk është lënë asnjë afat për zgjidhjen e problemeve të konstatuara dhe asnjë rekomandim me synim që këto subjekte të pajisen me Leje Mjedisi, duke vepruar kështu në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit.

Për këtë rekomandoj:

Kryeinspektori i DR ISHMP Durrës në bashkëpunim me përgjegjësën e Sektorit të Inspektimit të Mjedisit të hartojnë një plan pune inspektimi për të gjitha qendrat shëndetësore të Qarkut Durrës, të cilat janë të pa pajisura me Leje Mjedisore dhe të lënë rekomandime me afate për pajisjen e tyre me Leje Mjedisi, në mënyrë që këto subjekte shëndetësore të ushtrojnë aktivitetin e tyre konform kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë

11-Nga evidenca e grumbulluar dhe raportimet e subjektit rezulton se DR ISHMP Durrës nuk ka hartuar strategji afatmesme apo vjetore, ku të përcaktohen objektivat sipas prioriteteve që duhet të arrijë, për plotësimin e misionit të ngarkuar nga kuadri rregullator në fuqi dhe veprimtarinë e saj e ka kryer duke u mbështetur në plane pune mujore me mundësi rastësore të planifikimit të inspektimeve, pa u mbështetur në një analizë të mirëfilltë e reale të mundësive, analizë të faktorëve që mbështesin dhe atyre që bëhen pengesë, në madhësisë së territorit dhe veçorive të zonës referuar karakteristikave të mjedisit dhe pyjeve, në mundësinë e bashkëpunimit me aktorë të tjerë. Gjithashtu në institucion nuk ka një strategji të miratuar të riskut, nuk janë përcaktuar procedura të menaxhimit të riskut dhe nuk ekziston regjistri i identifikimit të risqeve dhe menaxhimit

të tyre. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Për këtë rekomandoj:

Kryeinspektori i DR ISHMP Durrës, në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues dhe Përgjegjësit e Sektorëve, në bazë të analizës së punës së institucionit dhe të rezultateve të saj, të hartojë strategjinë afatmesme dhe vjetore për vitin 2017, duke përcaktuar objektiva konkret dhe të matshëm të veprimtarisë së institucionit. Në këtë kuadër të vlerësohen ngjarjet apo fushat që parashikohen me risk për arritjen e objektivave, të renditen në një strategji të identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të riskut si dhe të caktohet koordinatori i riskut për ndjekjen e procesit në vazhdimësi, sipas përcaktimeve të MFK. Ndër objektivat kryesore të vlerësohet mundësia e përfshirjes së rifreskimit të rregullores së brendshme të institucionit, duke reflektuar në të kërkesat specifike të ligjit për MFK dhe akteve të tjera në fuqi.

Menjëherë

12-Nga DR ISHMP Durrës nuk janë hartuar dhe nuk janë dërguar në ISHMP Qendror dhe në Ministrinë e Mjedisit, pyetëtori vetëvlerësimit, dokumenti i deklaratës së vetëvlerësimit dhe raporti i cilësisë së sistemit të Kontrollit të Brendshëm , në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” .

Për këtë rekomandoj:

- Inspektorati DR ISHMP Durrës të hartojë dhe dërgojë në ISHMP Qendror dhe në Ministrinë e Mjedisit, pyetësin e vetëvlerësimit, dokumentin e deklaratës së vetëvlerësimit dhe raportin e cilësisë së sistemit të Kontrollit të Brendshëm në afatet ligjore.

Në vazhdimësi

13-DR ISHMP Durrës për periudhën e audituar nuk kishte përcaktuar rregulla të brendshme të miratuara lidhur me gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të përdorimit të fondeve buxhetore për shpenzimet për paga, shpenzimet operative sipas llojit, për administrimin e asetëve dhe materialeve të institucionit, si dhe të rregullave të procedurave të prokurimit publik, me synim garantimin e sigurisë së të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë që tu mundësojë audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse kuptimin dhe vlerësimin e mjedisit të kontrollit. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 9, pika 2 dhe nenin 16, pika 2, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Për këtë rekomandoj:

-Nga N/A dhe Titullari i institucionit (aktualisht në DR ISHMP Durrës Nëpunësi Autorizues është dhe Titullar institucioni), të ndiqen hapat e duhur ligjorë për instalimin dhe vendosjen e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) dhe të hartohen e miratohen rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave në zbatim të Ligjit.

Menjëherë

14-DR ISHMP Durrës, nga auditimi i në fletë udhëtimet të mbajtura rezulton se nuk janë evidentuar destinacionet përfundimtare të udhëtimit në rrethet përkatëse, duke u nisur dhe nga specifikat që ka ky inspektorat për inspektim në mjedis dhe pyje (pra destinacione larg qendrave urbane), për efekt të shmangies së interpretimeve jo të bazuara në dokumente dhe jo korrekte me aktet në fuqi. Kjo gjendje është në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 date 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Për këtë rekomandoj:

DR ISHMP Durrës, të hartojë fletë udhëtimet duke evidentuar destinacionet përfundimtare të udhëtimit në rrethet përkatëse, mbështetur në specifikat që ka ky inspektorat për inspektim në mjedis dhe pyje (pra destinacione larg qendrave urbane), me synim shmangien e interpretimeve jo të bazuara në dokumente dhe jo korrekte me aktet në fuqi. Për këtë të bashkëpunohet me Ministrinë e Transporteve si dhe Inspektoratin Qendror për të marrë referencat e distancave kilometrike brenda rrethit, të cilat nuk janë të publikuara zyrtarisht.

Në fletët udhëtimet të cilat janë dokumente që justifikojnë itinerarin e përshkruar, të vendosen destinacionet përfundimtare të udhëtimit dhe jo vetëm qendrat e qyteteve, si dhe çdo fletë udhëtimi të konfirmohet nga punonjësit udhëtues të autorizuar për inspektim.

Menjëherë

15-Nga titullari i DR ISHMP Durrës, nuk është ngritur një komision për testimin e konsumit të karburantit, për mjetet të cilat janë të përdorura, por është mbajtur një procesverbal nga specialistë jo të fushës përkatëse. Gjithashtu mungon dhe nuk është paraqitur një raport i përgjithshëm me detajet konkrete të përshkrimit të matjeve të kryera nga komisioni për km e përshkruar në rrugët konkrete dhe konsumin e karburantit për secilën kategori rruge .

Për këtë rekomandoj:

Në DR ISHMP Durrës, Titullari i institucionit çdo fillim viti, të ngrejë një komision për testimin e konsumit të karburantit nga mjetet e transportit dhe të paraqitet një raport, duke përshkruar në rrugë konkrete normativën e konsumit të karburantit për çdo kategori mjet udhëtimi.

Menjëherë

16-DR ISHMP Durrës nuk ka kryer inventarizimin e dosjeve të personelit sipas përcaktimeve të vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” sipas lidhjes 1 dhe lidhjes 2 .

Për këtë rekomandoj:

- DR ISHMP Durrës, sektori përkatës që mbulon burimet njerëzore, të marrë masa dhe të plotësojë dosjet e personelit me të gjitha të dhënat, konform kërkesave ligjore, si dhe çdo dosje të ketë inventarin e dokumentacionit të konfirmuar nga palët.

Menjëherë

17-Nga auditimi u konstatua se në dokumentet justifikuese të shpenzimeve për blerjet me vlerë të vogël, nuk ndodhej dokumentacioni i vërtetimit të llogaritjes së fondit limit. Ky veprim është në kundërshtim me Urdhërim nr. 3 datë 11.07.2013 ”Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlera të vogël dhe të lartë” .

Për këtë rekomandoj:

- DR ISHMP Durrës, komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, të kryejë përllogaritjen e fondit limit konform akteve në fuqi dhe të dokumentojë procedurën e ndjekur. Dokumentacioni argumentues i llogaritjes së fondit limit të jetë pjesë e praktikës së procedurës së prokurimit me vlerë të vogël.

Vazhdimisht

18-Nga auditimi i kryer në DR ISHMP për pasqyrat financiare rezultoi se:

Nga specialistja e financës pasqyrat financiare nuk janë mbajtur sipas ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për Kontabilitetit dhe Pasqyrave Financiare”, neni 7 pika 1 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”;

-Pasqyrat financiare nuk japin një pamje reale dhe të saktë të gjendjes financiare të institucionit në mbyllje të periudhës ushtrimore 2014-2015 e për rrjedhojë nuk i ofrojnë ndihmë menaxherëve të institucionit në marrjen e masave për arritjen e objektivave;

-Nuk ishte hartuar bilanci paraprak verifikues, me qëllim për të parë edhe procedurat e rakordimit, siç kërkon UMF nr. 14 datë 28.12.2006, pika 3;

-Në analizën e bilancit nuk është kryer llogaritja e amortizimit të mjeteve kryesore, në kundërshtim të udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006, sipas të cilit llogaritja e amortizimit vjetor bëhet mbi vlerën e mbetur;

-Bilanci kontabël së bashku me formatet (pasqyrat) financiare nuk janë shoqëruar me pyetëtorin përkatës, formatin nr. 12 “Pyetëtori dhe shënime shpjeguese për hartimin e llogarive të administrimit financiar të vitit”. Ky pyetëtor nuk ishte bashkëlidhur bilancit përkatës, me qëllim për të bërë disa saktësime e shpjegime të llogarive përkatëse.

Për këtë rekomandoj:

Specialisti i financës në DR ISHMP Durrës, të përgatisë bilancin verifikues, si dhe të plotësojë pasqyrat financiare konform rregullave në fuqi, duke e shoqëruar bilancin vjetor me relacionin dhe me përgjigjet e pyetëtorit si dhe me pasqyrat e llogaritjes së amortizimit të aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara të llogaritura mbi vlerën e mbetur, në respektim të udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006 dhe udhëzimit nr. 30 date 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kreu IV paragrafët 74,81.

Deri në 31.12.2016

19-Nga auditimi u konstatua se ditarët e veprimeve kontabël nuk mbaheshin konform VKM nr. 783, datë 22/11/2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”. Nga mos mbajtja e ditarëve të magazinës nuk janë kryer këto pasqyrime në bilancet e viteve 2014 e 2015, dhe si rezultat nuk është kryer kontabilizimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, pra nuk janë mbajtur kartelat dyfishë sipas udhëzimit nr. 30. date 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Si pasojë e këtyre mosveprimeve, nuk është kryer kuadrimi midis specialistes së financës dhe magazinës, në mënyrë që të saktësohet gjendja në fund të vitit.

- Konstatohet se vlera prej **1,625,221 lekë** është gjendje sipas vlerave kontabël të kartelave të magazinës për vitin 2014, por nuk është e pasqyruar si gjendje inventari në bilancin e këtij viti.

Vlera prej **45,556 lekë** është gjendje sipas vlerave kontabël të kartelave të magazinës për vitin 2015, por nuk është e pasqyruar si gjendje inventari në bilancin e këtij viti.

Për këtë rekomandoj:

Specialisti i financës në DR ISHMP Durrës, të marrë të gjitha masat për të çelur ditarët kontabël dhe të pasqyrojë veprimet ekonomike sistematikisht dhe në kronologji. Gjithashtu në bilancin e veprimtarisë së vitit 2016 të pasqyrohen e kontabilizohen veprimet e lëvizjes së vlerave materiale sipas kartelave të magazinës, të kuadruara dhe barazuara. Me veprim të veçantë të sistemohet nëpërmjet ditarit të veprimeve të ndryshme vlera prej **1,625,221 lekë** e pa sistemuar dhe pa kontabilizuar që i përket vitit 2014 dhe vlera **45,556 lekë**. që i përket vitit 2015. Mbajtja e kontabilitetit të bëhet në mënyrë të informatizuar nëpërmjet programeve informatike përkatëse.

Deri në 31.12.2016

20-Në listë pagesat e viteve 2014-2015 të DR ISHMP Durrës, nuk janë llogaritur, ndalur dhe derdhur sigurimet shtetërore suplementare për punonjësit, në kundërshtim me ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar me ligjin nr. 9990 date 15.09.2008, neni 1 pika 9, si dhe në kundërshtim me kërkesat e Vendimit nr 499, date 21.09.2000 pika 3 dhe 4.

Për këtë rekomandoj:

- DR ISHMP Durrës të kërkojë zyrtarisht pranë ISHMP që në mbështetje të akteve ligjore në fuqi cituar sa më sipërm, të ndërmarrë hapat përkatëse për përfshirjen e punonjësve të institucionit në listën e punonjësve që trajtohen me pensionet shtetërore suplementare si dhe të llogarisë, ndalë dhe derdh kuotën përkatëse të periudhës së viteve 2014-2015.

Menjëherë

21-Në DR ISHMP Durrës nuk është nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit dhe nuk është kryer inventarizimi i vlerave materiale monetare për vitet 2014-2015, në kundërshtim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik”.

-DR ISHMP Durrës nuk ka dokumentacionin e plotë, që u përket 2 automjeteve të transferuara nga ISHMP tek DR ISHMP Durrës, pasi mungon procesverbali i gjendjes teknike të marrjes në dorëzim, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësiti e Sektorit Publik” .

Për këtë rekomandoj:

-Kryeinspektori i DR ISHMP Durrës, në bashkëpunim me specialistin e financës, të kryejnë procedurat për inventarizimin e pasurisë duke u bazuar në kërkesat e Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësiti e Sektorit Publik”.

-DR ISHMP Durrës në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit të plotësojnë dokumentacionin e plotë për transferimet kapitale të automjeteve, sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësiti e Sektorit Publik”.

Menjëherë

22- DR ISHMP Durrës nuk ka përgatitur regjistrin e parashikimit të blerjeve me vlerë të vogël, në kundërshtim me nenin 4 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (*Trajtuar hollësisht në faqet 53-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandoj:

DR ISHMP Durrës të kryejë detajimin e buxhetit, të hartojë dhe të paraqesë çdo fillim viti kalendarik (brenda datës 15 Janar) në Institucionin Qendror ISHMP Tiranë, regjistrin e parashikimit të “Blerjeve me vlerë të vogël”, me synim përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet të fondet buxhetore.

23-Në DR ISHMP Durrës, nuk është bërë inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla. Këto mosveprime bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4, datë 04.07.2013, të Agjencisë së Prokurimit Publik, "Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë.

Për këtë rekomandoj:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në DR ISHMP Durrës, për çdo rast prokurimi për blerjet me vlerë të vogël, të kryejë inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të praktikave sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 4, datë 04.07.2013”.

Vazhdimisht

24-Titullari i DR ISHMP Durrës, pas prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, në asnjë rast nuk kishte ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të mallit. Ky mosveprim bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësiti e Sektorit Publik.

Për këtë rekomandoj:

Titullari i Institucionit të DR ISHMP Durrës, në çdo fillim viti të ngrejë komisionin për marrjen në dorëzim të mallit sipas UKM nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. DR ISHMP Durrës të marrë masa të kontabilizojë dhe të ndjekë të gjitha hapat e duhur ligjore për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik prej **884,400 lekë** të shkaktuar nga Kryeinspektori përgjegjësi sektorit të Policisë Pyjore dhe një punonjës i sektorit të mjedisit për përdorimin e pa justifikuar me dokumentacionin përkatës të karburantit për vitin 2015 si më poshtë vijon:

- vlerën prej **838,200 lekë** nga [REDACTED] Kryeinspektor.
- vlerën prej **23,925 lekë** nga [REDACTED] me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Pyjeve.
- vlerën prej **22,275 lekë** nga [REDACTED] me detyrë inspektor pranë Sektorit të Mjedisit .

Menjëherë

2. DR ISHMP Durrës të marrë masa të kontabilizojë dhe të ndjekë të gjitha hapat e duhur ligjore për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik prej **112,856 lekë**, si rezultat i përfitimit padrejtësisht nga punonjësi [REDACTED] të “Vlerës së Pagës së Grupit”, të përcaktuar në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE.

C/1. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, i rekomandoj Kryeinspektorit të ISHMP-së, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “Largim nga shërbimi civil” për:

1- [REDACTED] me detyrë Kryeinspektor i DR ISHMP Durrës, pasi nga auditimi konstatohet se:

- Nuk janë respektuar afatet ligjore si dhe janë dërguar me vonesë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv pranë Gjykatës Administrative të rrethit Gjyqësor Durrës, pas kalimit të

afatit 30 ditor nga data e vendosjes së saj, sipas përcaktimeve në nenin 44, të ligjit nr. 10279, dt 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, dhe nenit 46 të ligjit nr. 10433, dt 16.6.2011, “Për Inspektim në Republikën e Shqipërisë”.

-Për 13 vendimet e tjera të dënimeve me gjobë nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e DR ISHMP-së Durrës për t’u informuar nëse ka vendim nga ana e gjykatës për këto kërkesa.

- Për 25 Vendimet për Dënim Administrativ, edhe pse ka kaluar afati për shlyerjen vullnetarisht të masës së gjobës, apo ankimimit administrativ, nga DR ISHMP Durrës nuk është bërë kërkesa në gjykatë për lëshimin e titullit ekzekutiv të gjobës, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 44 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenit nr. 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

- Në disa raste autorizimet e lëshuara për inspektime nuk janë bërë sipas objektit dhe qëllimit të inspektimit të programit mujor të hartuar. Gjithashtu autorizimet në përgjithësi nuk janë plotësuar sipas elementëve të përcaktuara në përmbajtjen e autorizimit. Në autorizimet e lëshuara nuk është përcaktuar kohëzgjatja e autorizimit, veprime këto në kundërshtim me nenin 28 dhe 29 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

-Nuk ka plotësuar detyrimin sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10279, dt 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative” pasi nuk ka raportuar çdo muaj me shkrim tek Drejtorët e Drejtorive të Inspektimit sipas fushave përkatëse dhe nuk ka përcjellë raportimet e sektorëve sipas modeleve të miratuara nga ISHMP, si dhe një kopje origjinale të procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjes dhe vendimeve të dënimit me gjobë.

-Nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e komisionit “Për inventarin e përgjithshëm dhe inventarin e imët”, në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik”.

C/2. *Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”,nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, i rekomandoj kryeinspektorit të DR ISHMP Durrës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “Largim nga shërbimi civil” për personat e mëposhtëm:*

I- ■■■ me detyrë Jurist pranë DR ISHMP Durrës, pasi nga auditimi konstatohet se:

- Nuk janë respektuar afatet ligjore si dhe janë dërguar me vonesë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv pranë Gjykatës Administrative të rrethit Gjyqësor Durrës, pas kalimit të

afatit 30 ditor nga data e vendosjes së saj, sipas përcaktimeve në nenin 44, të ligjit nr. 10279, dt 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, dhe nenit 46 të ligjit nr. 10433, dt 16.6.2011, “Për Inspektim në Republikën e Shqipërisë”.

-Për 13 vendimet e tjera të dënimeve me gjobë nuk është ndërmarrë asnjë veprim për t’u informuar nëse ka vendim nga ana e gjykatës për këto kërkesa.

- Për 25 Vendimet për Dënim Administrativ, edhe pse ka kaluar afati për shlyerjen vullnetarisht të masës së gjobës, apo ankimit administrativ, nuk është bërë kërkesa në gjykatë për lëshimin e titullit ekzekutiv të gjobës, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 44 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenit nr. 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Si pasojë e këtyre mosveprimeve është shkaktuar e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit në vlerën prej **32,538,000 lekë**.

2- ■■■ me detyrë specialiste finance pranë DR ISHMP Durrës, pasi nga auditimi konstatohet se:

Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9228 date 29.04.2004, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrave Financiare”, neni 7 pika 1 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”;

-Pasqyrat financiare nuk japin një pamje reale dhe të saktë të gjendjes financiare të institucionit në mbyllje të periudhës ushtrimore 2014-2015 e për rrjedhojë nuk i ofrojnë ndihmë menaxherëve të institucionit në marrjen e masave për arritjen e objektivave;

-Në këtë institucion të audituar, mungon bilanci paraprak verifikues, për të audituar procedurat e rakordimit, në zbatim të UMF nr. 14 datë 28/12/2006, pika 3;

-Bilanci kontabël së bashku me formatet (pasqyrat) financiare nuk janë shoqëruar me pyetësorin përkatës, formati nr. 12 “Pyetësori dhe shënime shpjeguese për hartimin e llogarive të administrimit financiar të vitit”. Ky pyetësor nuk ishte bashkëlidhur bilancit përkatës, me qëllim për të bërë disa saktësime e shpjegime të llogarive përkatëse;

-Rezultoi se ditarët e veprimeve kontabël nuk mbaheshin konform VKM nr. 783, datë 22/11/2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, e konkretisht Kapitulli I “Mbajtja e kontabilitetit”;

-Nga mos mbajtja e ditarëve të magazinës nuk janë kryer këto pasqyrime në bilancet e viteve 2014 e 2015 dhe si rezultat nuk janë kryer kontabilizimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, pra nuk janë mbajtur kartelat dyfishë sipas udhëzimit nr. 30. date 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, si pasojë nuk është kryer kuadrimi midis specialistes së financës dhe magazinës, në mënyrë që të saktësohet gjendja në fund të vitit;

- Vlera prej **1,625,221 lekë** është gjendje sipas vlerave kontabël të kartelave të magazinës për vitin 2014, por nuk është e pasqyruar si gjendje inventari në bilancin e këtij viti;

- Vlera prej **45,556 lekë** është gjendje sipas vlerave kontabël të kartelave të magazinës për vitin 2015, por nuk është e pasqyruar si gjendje inventari në bilancin e këtij viti;

- Ka kryer për vitin 2014 dhe janar 2015 pagesën e “Vlerës së Pagës së Grupit”, të përcaktuar në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve

të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve”, përfituar padrejtësisht nga punonjësi ■■■ në vlerën prej **112.856 lekë**.

C/3. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, **i rekomandoj kryeinspektorit të DR ISHMP Durrës**, për dhënien e masës disiplinore “**Vërejtje**” për personat e mëposhtëm:

- 1 ■■■ me detyrë Inspektor të Inspektimit të Mjedisit
- 2 ■■■ me detyrë Inspektor të Inspektimit të Mjedisit
- 3 ■■■ me detyrë Inspektor të Inspektimit të Mjedisit
- 4 ■■■ me detyrë Inspektor të Inspektimit të Mjedisit
- 5 ■■■ me detyrë Inspektor të Inspektimit të Mjedisit
- 6 ■■■ me detyrë Inspektor të Inspektimit të Mjedisit
- 7 ■■■ me detyrë Inspektor të Inspektimit të Mjedisit
- 8 ■■■ detyrë Inspektor të Inspektimit të Mjedisit
- 9 ■■■ me detyrë përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Mjedisit

Për arsye se:

- Nga subjektet e inspektuara gjatë vitit 2014 dhe vitit 2015, me kundërvajtje administrative, rezulton se për procedurat e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, një pjesë e subjekteve të inspektuara e zhvillonin aktivitetin e tyre pa leje mjedisi.

Në mbajtjen e procesverbaleve të inspektimit, nuk evidentohen subjektet me numër NIPT-i, kanë lënë afate në kohë të ndryshme për t’u pajisur me leje mjedisore, nuk kanë bërë riinspektime për të kontrolluar nëse subjekti i ka realizuar detyrat e lëna. Këto mangësi e shkelje janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

- Këta inspektorë kanë hartuar procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjeve administrative si dhe vendimet për dënim administrativ, në të cilat mungon nënshkrimi i personit përgjegjës të kontrolluar dhe data e marrjes së kopjes së vendimit për dënim administrativ.

Në rastin kur është kundërshtuar nënshkrimi i procesverbaleve dhe i vendimit për dënim administrativ, nga ana e inspektorëve nuk është evidentuar ky fakt, veprim ky në kundërshtim me pikën 2, neni 14 të ligjit nr. 10279 dt 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

10 ■■■ me detyrë inspektor i Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore

11. [REDACTED] me detyrë inspektor i Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore
12. [REDACTED] me detyrë inspektor i Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore
13. [REDACTED] me detyrë inspektor i Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore
14. [REDACTED] me detyrë inspektor i Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore
15. [REDACTED] me detyrë inspektor i Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore
16. [REDACTED] me detyrë inspektor i Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore
17. [REDACTED] me detyrë inspektor i Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore
18. [REDACTED] me detyrë inspektor i Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore

Për arsye se:

-Nga subjektet e inspektuara për vitin 2014-2015, rezulton se për procedurat e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, në mbajtjen e procesverbaleve të inspektimit, procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjeve administrative si dhe vendimeve për dënim administrativ, mungon nënshkrimi i personit përgjegjës të kontrolluar dhe data e marrjes së kopjes së vendimit për dënim administrativ. Në rastin kur është kundërshtuar nënshkrimi i procesverbaleve dhe i vendimit për dënim administrativ, nga ana e inspektorëve nuk është evidentuar ky fakt, veprim ky në kundërshtim me pikën 2, neni 14 të ligjit nr. 10279 dt 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

- Në lidhje me raportimet ditore, që plotësohen nga ana e inspektorëve të Policisë Pyjore, pasi kanë kryer inspektimet, në bazë të autorizimeve përkatëse, vihen re pasaktësi dhe mangësi në plotësimin e këtyre raporteve si:

- në disa raste data e plotësimit të raportit ditor nuk është e njëjtë me datën e inspektimit që do të kryhet, e përcaktuar në autorizim;
- nuk ka të dhëna për përcaktimin më të qartë në lidhje me vendndodhjen e subjekteve të inspektuara si në rastet e inspektimeve rastësore ashtu dhe në ato të programuara.

C/4. Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, do të kërkonim të fillonin procedurat për dhënien e masës disiplinore për [REDACTED] me detyrë ish-Kryeinspektor i DR ISHMP Durrës për vitin 2014, me të cilin rezulton se janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Për këtë punonjës nuk është propozuar masë disiplinore, pasi masa ndaj tij konsiderohet e ezauruar. Masa e propozuar do të ishte “Largim nga shërbimi civil”, pasi nga auditimi konstatohet se:

- Një pjesë e programeve të inspektimit për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga veprimtaritë e paligjshme nuk janë hartuar me afate dhe detyra konkrete me qëllim parandalimin e dëmtimeve dhe reduktimin e prerjeve të paligjshme;
- Procedimi administrativ i inspektimit fillon me lëshimin e autorizimit të inspektimit nga kryeinspektori në bazë të programit të inspektimit;

-Për Sektorin e Policisë Pyjore për vitin 2014 nuk janë lëshuar autorizime inspektimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011“Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

- Nuk ka plotësuar detyrimin sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10279, dt 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, pasi nuk ka raportuar çdo muaj me shkrim tek Drejtorët e Drejtorive të Inspektimit sipas fushave përkatëse dhe nuk ka përcjellë raportimet e sektorëve sipas modeleve të miratuara nga ISHMP, si dhe një kopje origjinale të procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjes dhe vendimeve të dënimit me gjobë; Për sa sipër të merren masa të njoftohet Departamenti i Administratës Publike për masën disiplinore, mbi bazën e shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Shënim: Materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Departamentit .

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R